



Republika e Kosovës

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC

Opština Skupština / Municipality of Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 129 Nr. i faq./Br.str./No pg 01/02

Data/Datum/Date 30 / 08 / 2023



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negociim me Nr. Prot. 01 Nr. 394/22 i datës 25.11.2022, Kërkesës për kushte ndërtimore të Fondacionit "Adrian Orllati" me Nr. Prot. 12-320/04-0036941/23 të datës 20.09.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.08.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e lejes për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore

1. Me këtë vendim i lejohet Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit dhënia e lejes për kushte ndërtimore dhe lejes ndërtimore për Fondacionin "Adrian Orllati" sipas kërkesës me Nr. Prot. 12-320/04-0036941/23 të datës 20.09.2023 për ndërtimin e objektit P+4.
2. Dhënia e kushteve ndërtimore dhe lejes ndërtimore sipas pikës 1 të këtij vendimi i lejohet në parcelën kadastrale P-71510057-08924-0 për ndërtimin e objektit për strehimin dhe kujdesin ndaj personave shtyer në moshë si dhe ndërtimin e aneks objektit për banorët ekzistues në këtë parcelë sipas nenit 6 pika 6.7 të Kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit me negociim me Nr. Prot. 02/186/23 të datës 16.2.2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe arsyetimi.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së,
- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Shërbimit të Kuvendit, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.129/ 23
Datë:30.08.2023

